



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 13587 / Prot.

Tiranë, më 03.09.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Z. FATMIR XHAFAJ

Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”

KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar Zoti Xhafaj,

Në përgjigje të kërkesës Tuaj nr. 3022 Prot., datë 31.07.2024, ku kërkohet caktimi i dy përfaqësuesve/ekspertë (prokurorë) dhe të paktën dy profesionistë nga stafi ynë në grupin e punës pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit, dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, dëshirojmë t’Ju informojmë se institucioni ynë është plotësisht i angazhuar në përpjekjet për anëtarësimin sa më të shpejtë të Shqipërisë në BE.

Vlen të theksojmë se Prokuroria e Posaçme ka luajtur një rol kyç në grup kapitujt themelorë të këtij procesi, përfshirë kapitullin 23 dhe kapitullin 24. Institucioni ynë raporton periodikisht pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme dhe në takimet e Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian mbi përmbushjen e detyrimeve, masat e marra, treguesit e performancës, dhe sfidat e hasura. Përveç kësaj, raporti ynë vjetor përfshin në mënyrë të detajuar masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe përmbushjen e detyrimeve institucionale në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

Në konsideratë të shkresës Tuaj, në Mbledhjen e Prokurorëve të Posaçëm të datës 03.09.2024, u diskutua dhe kjo kërkesë, ku prokurorët e posaçëm shprehën vlerësim mbi çdo iniciativë të Kuvendit për të bashkëpunuar me institucionet e drejtësisë për përmirësimin e sundimit të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke respektuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushtetit.

Prokurorët e Posaçëm gjithashtu shprehën bindjen se një bashkëpunim institucional që respekton balancat kushtetuese dhe përmbush standardet ndërkombëtare është themeli për arritjen e objektivave tona të përbashkëta në forcimin e shtetit ligjor dhe përshpejtimin e procesit të integritetit të vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Në këtë Mbledhje, në mënyrë unanime u ra dakord se tashmë institucioni ynë, përmes raportimit vjetor, ka bërë publike problematikat e hasura mbi funksionimin e tij dhe efektivitetin e hetimit, duke përfshirë dhe nevojat për ndryshime ligjore përkatëse.

Për sa më lart, Prokuroria e Posaçme shpreh gatishmërinë për të kontribuar në përpjekjet e përbashkëta për përmirësimin e sundimit të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme përmes dhënies së mendimeve ligjore sa herë që të konsiderohet e nevojshme nga ana juaj.

Faleminderit për bashkëpunimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI

